

**Znj. Yllka Pulashi (Malaj)** është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në korrik të vitit 2000, në degën financë. Certifikuar me Certifikatë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik viti 2013, master profesional dega “E drejtë administrative”, në Universitetin Evropian të Tiranës në vitin 2013, Certifikate për kursin e ndjekur online mbi Auditimin në mjedis, Impakti dhe Infrastruktura, 9 janar -5 Shkurt 2017 organizuar nga Office of Academic Affairs University of Tartu, Certifikate për kursin e ndjekur online mbi Auditimin e çështjeve të mjedisit dhe prezencën e auditimit në sektorin publik, 31 tetor -27 nëntor 2016 organizuar nga Life Long Center, Certifikate për trajnimin e menaxhimit të riskut projekti IPA maj 2017, Certifikate për kursin e ndjekur online mbi Menaxhimin Financiar dhe Sistemin e Kontrollit (MFK) për fondet buxhetore shkurt-mars 2015 organizuar CEF Slloveni etj.

Prej dhejtor 2000 e në vazhdim (2021) ka punuar si audituese e parë, audituese e lartë, kryeaudituese, Drejtor Drejtorie dhe Drejtor Departamenti Auditimi në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe aktualisht është Drejtor e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, nga muaji prill i vitit 2022 e në vijim.

Ka një eksperiencë të gjatë audituese, kualifikime brenda dhe jashtë vendit në SAI, gjykata llogarish si dhe me organizata ndërkombetare të auditimit, në fushën e auditimit, planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, standardet ndërkombetare të auditimit, prokurimeve publike, projekteve me financime të huaja, riskut të auditimit, etj.

Përgjatë karrierës ka publikuar disa artikuj në medianë e shkruar të cilat adresojnë tema rreth ekonomisë, rolin e institucioneve supreme të auditimit për të mirën e menaxhimit të fondeve publike. Gjithashtu, ka organizuar disa work-shop me praktikën dhe standardin më të mirë për auditimin dhe procedurat e tij, si dhe ka shërbyer si trajnuese në disa tema për auditimin e shoqërive publike dhe investimeve të huaja, koncesioneve/PPP etj.